



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS SEMAN**

VENDIMI

Nr. 7, datë 20.12.2019

**PËR
MIRATIMIN E LEJES SË SHFRYTËZIMIT TË BURIMIT UJOR PËRROI I
BACKËS, BASHKIA SKRAPAR, QARKU BERAT, PËR QËLLIME
TEKNOLOGJIKE NGA KOMPANIA "SPEICAPAG".**

Në mbështetje të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.111/2012, i ndryshuar me ligjin 6/2018, datë 8.2.2018, për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore", VKM nr. 221, datë 26.4.2018, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ", si dhe të VKM-së nr. 416, datë 13.5.2015, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 6, datë 12.6.2019, "Për miratimin e rregullores", "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", me propozim të Z.A.B.U. Shkumbin-Seman, Këshilli i Basenit Seman

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes "Për Shfrytëzimin e Burimit Ujor përroi i Backës" subjektit "Speicapag" me objekt "Shfrytëzimi i Burimit Ujor për qëllime teknologjike".
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I K B U S E M A N

BAKI BALA

